

R E L A C I O N
P Ë R
PROJEKTLIGJIN
“P Ë R
DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, ‘PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’, I
NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 81, pika 1, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe propozohet në kuadër të Paketës Fiskale 2026.

Ky projektligj ka si qëllim të mbështesë dhe lehtësojë prodhuesin bujqësor (fermerin), nëpërmjet rishikimit të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë, duke prezantuar një normë dhe procedurë të re të kompensimit të prodhuesve bujqësorë.

Me anë të këtij projektligji synohet që fermeri të kompensohet me një normë prej 10 për qind për tatimin mbi vlerën e shtuar e paguar për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, në funksion të realizimit të aktiviteteve të tij prodhuese bujqësore. Objektivi i këtij projektligji është edhe përfitimi i kompensimit nga fermeri në një mënyrë sa më efektive dhe funksionale, nëpërmjet administratës tatimore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Nga viti 2014 e në vijim, ligji nr. 92/2014 “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, në Kreun XI “Regjime të veçanta”, Seksioni 4, nenet 145-150, ka parashikuar skemën e kompensimit të prodhuesve bujqësorë (fermerë) me normë kompensimi (flat rate), objekti, kushtet dhe mënyra e funksionimit të së cilës, janë në të njëjtën linjë me dispozitat përkatëse të Direktivës së Këshillit 2006/112/KE “*Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar*”, të ndryshuar.

Sikurse është parashikuar edhe në Direktivën e mësipërme që rregullon tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në nivel komunitar, skema e kompensimit të prodhuesve bujqësorë (Common flat-rate scheme for farmers) mund të aplikohet kur *zbatimi tek fermerët i regjimit normal sjell vështirësi*.

Ndër të tjera, Direktiva 2006/112/KE, e ndryshuar, në nenet 299 dhe 301 të saj ka parashikuar se:

- Norma e kompensimit nuk mund të ketë efektin e një kompensimi më të madh sesa TVSH-ja e paguar në inputet e fermerëve.
- Kompensimi sipas skemës i paguhet fermerit, ose nga blerësi, ose nga autoritetet publike.

Kompensimi i prodhuesve bujqësorë me normë fikse është një mekanizëm i TVSH-së, për ata fermerë që nuk i nënshtrohen TVSH-së dhe si të tillë, as nuk ngarkojnë TVSH për blerësit e produkteve të tyre bujqësore, por as kanë të drejtë të zbresin TVSH-në e paguar në blerje. Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë prej 10 për qind ka si qëllim t’i kompensojë ata për një pjesë të TVSH-së që paguajnë për inputet, në funksion të realizimit të prodhimeve të tyre bujqësore. Mënyra e propozuar me këtë projektligj është ajo nëpërmjet administratës tatimore, mënyrë kjo e aplikueshme edhe nga vende të tjera, si për shembull, Franca dhe Greqia. Duke qenë se, skema e kompensimit me rimbursim nëpërmjet administratës tatimore do të zbatohet për herë të parë, në funksion të mirëadministrimit, propozohet që skema të kufizohet duke përcaktuar që blerësi i produkteve bujqësore duhet të jetë një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në, i cili ushtron aktivitet si, grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për turizmin.

Vende të tjera të Ballkanit Perëndimor që kanë zgjedhur të aplikojnë këtë skemë janë Bosnje-Hercegovina, me një normë kompensimi prej 5%, si dhe Kosova, Serbia dhe Mali i Zi, të cilat kanë një normë kompensimi prej 8%, e ndryshme nga shkalla standarde e TVSH-së që varion nga 17-21%.

Ndërsa, në vendet e Bashkimit Evropian që aplikojnë këtë skemë, norma e kompensimit varion nga rreth 2-12%, e ndryshme nga shkalla standarde e TVSH-së që varion nga rreth 19-25%.

Aktualisht, norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor, sipas nenit 148 të ligjit nr. 92/2014, i ndryshuar, është zero për qind. Ligji ka parashikuar edhe disa incentiva nga pikëpamja e TVSH-së për sektorin e bujqësisë, të cilat konsistojnë në përjashtime nga TVSH-ja dhe shkallë të reduktuara të TVSH-së, si më poshtë:

❓ Përjashtimi nga TVSH-ja për:

- furnizimin e makinave bujqësore.
- importimin e makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e agrobiznesit pavarësisht nga vlera e investimit.
- importimin e kafshëve të gjalla për majmëri, kafshëve të gjalla racë pastër, barrëse ose jobarrëse për riprodhim (speciet gjedhë, dhenë, dhi, derra dhe njëthundrakë), si dhe materialit biologjik që përdoret për inseminimin artificial.
- importimin e insekteve të dobishme, të cilat përfshihen në kodet 0106 41 00, 0106 49 00 dhe 0106 90 00, si dhe grackave të ndryshme përfshirë letrat ngjitëse dhe ferromonet, që përdoren kundër insekteve të dëmshme.

❓ Shkallë e reduktuar e TVSH-së prej:

- **6%**, për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit, me përjashtim të pijeve, për strukturat që zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”.
- **10%**, për furnizimin e inputeve bujqësore, ku përfshihen plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, me përjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Përpos mbështetjes me politika tatimore, sektori i bujqësisë mbështetet edhe me politikën buxhetore të subvencioneve nga buxheti i shtetit.

- Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave rezulton se, nga viti 2022 kur u vendos norma 0% e kompensimit për fermerët, ka pasur një rritje dyfish të fermerëve që përfitojnë nga subvencionet dhe rritje dyfish të shumës së dhënë subvencion.
- Për vitin 2024 janë rreth 14 mijë fermerë që kanë marrë 2,64 miliardë lekë subvencione.
- Nga viti 2022 është përfshirë në masat mbështetëse subvencionimi i naftës, nga e cila në vitin 2024 kanë përfituar rreth 31,500 fermerë në shumën prej 1,25 miliardë lekë.

Në bazë të të dhënave të administratës tatimore rezulton se, në vitin 2024 janë rreth 9,875 fermerë që kanë shitur produktet e tyre tek 659 blerës.

Tre janë elementet kryesore ku konsiston projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”:

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”.

1. Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësorë **nga 0 (zero) për qind të bëhet 10 (dhjetë) për qind.**
2. **Blerësi i produkteve bujqësore** duhet të jetë një person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në, i cili ushtron aktivitet si, grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për turizmin.
3. **Kompensimi do t'i paguhet shitësit-fermer nga administrata tatimore.**

Propozimet sipas këtij projektligji marrin në konsideratë incentivat aktuale për sektorin bujqësor (trajtimi me shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 10%, përjashtimet nga TVSH-ja brenda vendit dhe në import, si dhe subvencionimi për naftën), përfshirë këtu edhe faktin se kompensimi i fermerëve direkt nëpërmjet blerësit, skemë kjo e aplikuar më herët, nuk ka rezultuar të jetë funksionale.

Trajtimi si sa më sipër nëpërmjet skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë synon të kontribuojë në forcimin e ekonomisë dhe formalizimin e sektorit bujqësor, duke nxitur pajtueshmërinë dhe zbatueshmërinë nga ana e palëve të përfshira në transaksion. Blerësi detyrohet të lëshojë faturën tatimore të fiskalizuar, dokument ky i nevojshëm për qëllime të njohjes së shpenzimeve tatimore të zbritshme, ndërsa fermeri duhet ta kërkojë dhe disponojë këtë faturë në funksion të përfitimit të kompensimit sipas këtij projektligji.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 81, pika 1, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE)

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”, synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

Ky projektligj është në përputhje të pjesshme me Direktivën 2006/112/KE të Këshillit “*Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar*”, të ndryshuar.

Bashkëlidhur janë edhe tabelat e përputhshmërisë, të përgatitura në gjuhën shqipe dhe angleze.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT

Projektligji përbëhet nga 4 nene, të cilat konsistojnë në disa ndryshime në Kreun XI “Regjime të veçanta”, seksioni 4, të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vijojnë si më poshtë:

Në nenin 1 është parashikuar që *norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë është 10 për qind.*

Neni 2 ka parashikuar që në nenin 149 “*Vlera e kompensimit*”, pika 3 të ndryshohet si më poshtë:

“3. Shuma që kompensohet është rezultat i shumëzimit të normës së kompensimit me vlerën totale të produkteve dhe shërbimeve bujqësore, të furnizuara nga prodhuesi bujqësor, përgjatë një periudhe gjashtë mujore.”.

Në nenin 3 është parashikuar një riformulim i nenit 150 “*Mënyra e zbatimit të skemës*”, si më poshtë:

“1. Blerësi i produkteve bujqësore, person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në, i cili ushtron aktivitet si, grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për turizmin, lëshon një faturë tatimore për shitësin, prodhues bujqësor për çdo furnizim mallrash dhe shërbimesh të marrë prej tij. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi për llogari të shitësit, mbi të cilën aplikohet norma e kompensimit, sipas këtij ligji.

2. Forma dhe përmbajtja e faturës janë përcaktuar në nenin 101, të këtij ligji, në përputhje me natyrën e furnizimit. Në faturë duhet të shënohet NIPT-i sipas nenit 147, shkronja “ç”, të këtij seksioni.

3. Kompensimi i akorduar i paguhet prodhuesit bujqësor nga administrata tatimore. Për të përfituar këtë kompensim, shitësi, prodhues bujqësor, duhet të dorëzojë në administratën tatimore, nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike, një kërkesë për kompensim, të shoqëruar me kopje të faturave të lëshuara nga blerësi i mallrave dhe shërbimeve bujqësore, si dhe numrin e llogarisë së tij bankare. Kërkesa për kompensim paraqitet sipas periudhave të mëposhtme:

a. brenda datës 31 Dhjetor, për furnizimet e kryera gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit përkatës.

b. brenda datës 30 Qershor të vitit pasardhës, për furnizimet e kryera gjatë periudhës Korrik-Dhjetor të vitit paraardhës.

4. Administrata tatimore kryen kompensimin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.”.

Neni 4 ka parashikuar hyrjen në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare dhe shtrirjen e efekteve duke filluar nga data 1 janar 2026.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet administrata tatimore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe i është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator. Gjithashtu, ky projektligj është koordinuar edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në cilësinë e institucionit të ngarkuar me zbatimin e tatimit mbi vlerën e shtuar në vendin tonë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji parashikohet të sjellë efekte financiare negative.

Bazuar në të dhënat e administratës tatimore përgjatë viteve 2018-2021 kur norma e kompensimit të fermerëve ka qenë 20% apo 6%, si dhe të dhënat e viteve 2022-2024- parashikimet për vitin 2025, kur norma e kompensimit të fermerëve ka qenë 0%, rezulton se nga zbatimi i normës së kompensimit prej 10 për qind, efekti për vitin 2026, si viti i parë i zbatimit, është rreth 1,5 miliardë lekë.

MINISTRI

Petrit Malaj